

VENDIM
Nr. 764, datë 19.12.2025

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 505, DATË 27.7.2022, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR
FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT TË OBJEKTIT TË KOMISARIATIT TË
POLICISË NR. 5, KAMZË, DHE CAKTIMIN E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME
TË POLICISË SË SHTETIT SI NJËSI ZBATUESE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” e “iii”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2, të vendimit nr. 505, datë 27.7.2022, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Në buxhetin e miratuar për vitin 2025 për Ministrinë e Punëve të Brendshme, në programin buxhetor “Policia e Shtetit” 03440, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, shtohet fondi prej 3 690 000 (tre milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë mijë) lekësh pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit të objektit të Komisarariatit të Policisë nr. 5, Kamzë, i cili do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2025.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama